



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

**Raport i Akreditimit Institucional
të Akademisë “Ivodont”**

Janar 2020

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Prof. Dr. Anila Hoda Kryetare
2. Prof. As. Hemion Braho Anëtar

Contents

Rreth këtij vlerësimi	4
Konteksti i këtij vlerësimi	4
Raporti përmbledhës	6
Përmbledhje e gjetjeve	8
Rekomandimet	9
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	10
Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi.....	10
Gjykim i përmbledhur	11
Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Drejtimi i tij.....	12
Gjetjet	14
Rekomandimet	14
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	14
Gjykimi.....	14
Fusha e vlerësimit 2: Burimet	15
Gjetjet	17
Rekomandimet	17
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	18
Gjykimi.....	18
Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula	19
Gjetjet	21
Rekomandimet	21
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	21
Gjykimi.....	21
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	22
Gjetjet	24
Rekomandimet	24
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	24
Vendimi.....	24
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e Tyre	25
Gjetjet	26
Rekomandimet	26
Pohimi i veprimeve të ndërmarra.....	27
Gjykimi.....	27
Lista e evidencave	28

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle Akademia “Ivodont” përmbush Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i vlerësimit të jashtëm, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë dhe Shqiptarë të caktuar nga ASCAL.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga Akademia “Ivodont”, por edhe për t’iu ofruar palëve të interesit, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë janë grupuar në pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Drejtimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjyimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar ASCAL-it dhe Bordit të Akreditimit një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, ASCAL-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t’i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Akademia “Ivodont” është emërtimi pas riorganizimit të Institucionit Plotësues Parauniversitar Privat “Ivoclar Vivadent & Partners”, i licensuar nga Këshilli i Ministrave

me Vendimin Nr. 178, datë 19.02.2009. Kolegji Profesional Privat “Ivoclar Vivadent & Partners” u akreditua për një periudhë 6-vjeçare me Urdhër të Ministrit Nr. 328, datë 15.08.2013, dhe më pas u riorganizua në Akademinë "Ivodont" me Urdhër Nr. 598, datë 21.12.2016. Që prej hapjes së tij, ky Institucion ka ofruar vetëm një program studimi të ciklit të parë në nivelin Bachelor në degën “Teknikë e Lartë Dentare”. Në vitin 2014, pati një pezullim të veprimtarive të Akademisë “Ivodont” (AI) për papajtueshmëri me kërkesat ligjore të ligjit, konkretisht me numrin prej 7 Profesorësh të kërkuar nga ligji (Vendim i Kryeministrit Nr. 540, datë 06.08.2014). Kjo periudhë 2-vjeçare pezullimi shkaktoi ndikim negativ në performancën e Institucionit, vështirësi në lidhje me riorganizimin në përputhje me kërkesat ligjore dhe gjithashtu në regjistrimin e një numri të studentëve. Veprimtaria akademike gjatë këtyre dy viteve u përqendrua kryesisht në përfundimin e studimeve për studentët ekzistues, pa pasur mundësinë për të regjistruar studentë të rinj.

Pas heqjes së urdhrit të pezullimit në vitin 2016, Kolegji Profesional Privat “Ivoclar Vivadent & Partners” analizoi hapat e zhvillimit për të ardhmen. Në përfundim të analizës, u vendos që institucioni do të ndryshonte organizimin profesional, profilin akademik, si dhe emrin. Në shtator 2016, u miratua një Statut i ri dhe organizimi i institutit u ndryshua nga “Kolegj Profesional” në “Akademi” nën emrin e ri “Ivodont”. Kjo bëri të mundur që të gjitha aktet e brendshëm rregullatorë të ishin në pajtueshmëri me organizimin e ri institucional dhe ligjet në fuqi. I gjithë procesi u zhvillua në përputhje me politikat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me të cilën Akademia “Ivodont” ka nënshkruar një marrëveshje (Nr. 5069, datë 06/06/2019), ku Akademisë i lejohet të ketë një numër stafi akademik më të ulët se sa 7.

Orientimi i ri i strategjisë së Akademisë “Ivodont” është drejt tregut të punës dhe Institucioni po punon edhe me partnerë ndërkombëtarë për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjes së studentëve.

Raporti përmbledhës

Akademia "Ivodont" është institucion privat i arsimit të lartë, që ka filluar veprimtarinë në vitin 2004 dhe është licensuar në vitin 2009 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Akademia "Ivodont" është ndër Institucionet e para private në Republikën e Shqipërisë në këtë fushë, dhe që aktualisht është e organizuar në një fakultet: Fakulteti i Teknikave Dentare. Akademia ndodhet në Tiranë dhe operon në dy ndërtesa në qendër të Tiranës.

Akademia ofron një program studimi të ciklit të parë në "Teknikë e Lartë Dentare", dhe përdor Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).

Ky është Vlerësimi i dytë Institucional i Akademisë dhe i pari pas përfundimit të pezullimit në vitin 2016, për vlerësimin e nivelit të përmbushjes së Standardeve Shtetërore Shqiptare të Cilësisë, që hynë në fuqi në vitin 2011.

Raporti bëri gjykimet e mëposhtme për secilën fushë Vlerësimi:

1. Standardet për Organizimin dhe Drejtimin e tij janë **përmbushur pjesërisht.**
2. Standardet për Burimet janë **përmbushur pjesërisht.**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur kryesisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur kryesisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur kryesisht.**

Grupi i Punës për Vetëvlerësim, ku përfshiheshin gjashtë persona nga Akademia me njohuri të gjera mbi Akademinë si dhe një përfaqësues i studentëve, hartoi një Raport Vetëvlerësimi. Grupi i punës u krijua nga Senati Akademik dhe detyrat u shpërndanë ndërmjet pjesëtarëve të grupit. Atyre iu mundësuan dokumente, statute dhe rregullore të brendshme të Akademisë, bashkërisht me të dhënat statistikore dhe raportet përkatëse. Projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë në Akademi, përpara përfundimit. Senati Akademik autorizoi lëshimin e raportit përfundimtar dhe dorëzimin e tij te Agjencia.

Vizita e vlerësimit u krye gjatë dy ditëve, në datat 4 dhe 5 nëntor të vitit 2019. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga një ekspert i arsimit të lartë me përvojë dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucioneve shqiptare dhe të huaja. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë para dhe gjatë vizitës.

Larmia e informacionit mbështetës të ofruar nga Akademia, i dha mundësinë grupit të njihje me strukturën, politikën dhe procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Këto dokumente përfshinin Statutin dhe Rregulloret, raportet e brendshme, raportin vjetor ndaj Ministrisë,

procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembujt e informacioneve rreth programit, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me menaxherë të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, personelin administrativ dhe mbështetës, me alumni si dhe partnerë të jashtëm gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm. Diskutimi shërbeu për qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe gjetjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë e turit të burimeve të mësimdhënies, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi Institucionin dhe vëzhgoi hapësirat e mësimdhënies, laboratorët dentarë dhe zyrat.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është në gjendje të konfirmojë që institucioni ka bërë përparim pas periudhës së pezullimit 2014-2016.

Standardet për Organizimin dhe Drejtimin e tij janë **përbushur pjesërisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë. Grupi identifikoi një dobësi lidhur me një rekomandim. Kjo lidhet me debatin gjithëpërfshirës dhe diskutimin në të gjitha nivelet formale të qeverisjes dhe drejtimit të Akademisë, në mënyrë që të sigurohet niveli i duhur i transparencës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se Akademia drejtohet në mënyrë efikase në përputhje me ligjin shqiptar dhe Statutin dhe Rregulloret e Akademisë. Akademia ka strukturën e komisionit të posaçëm, në të cilin personeli mund të marrë pjesë në mënyrë konstruktive, dhe Akademia ka zhvilluar një sërë partneritetesh të dobishme.

Standardet për Burimet janë **përbushur pjesërisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, identifikoi katër dobësi dhe bëri rekomandimet përkatëse, dhe nuk bëri pohime. Dobësitë kishin të bënin me praktikën e zhvillimit të personelit dhe procedurat e aksesit në fonde; procedurat e vlerësimit të stafit; përfshirjen e kufizuar të departamenteve dhe fakultetit në hartimin e buxhetit; sistemin qendror për drejtimin institucional. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet lidhur me shqetësimet për secilën nga dobësitë, konkretisht:

- Ngritja e mekanizmave për ofrimin e mbështetjes financiare për stafin në kuadër të veprimtarive të zhvillimit dhe krijimi i procedurave standarde për këtë qëllim.
- Hartimi i buxhetit duhet të jetë një proces 'nga poshtë lart' ku departamentet i paraqesin fakultetit propozimet për shpenzimet.
- Buxheti i miratuar duhet të publikohet në faqen e internetit dhe të gjithë pjesëtarët e stafit akademik duhet të informohen në mënyrë individuale.
- Vendosja e praktikave të mira nëpërmjet kontrollit të jashtëm financiar.
- Ngritja e një sistemi qendror për drejtimin institucional.

Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, identifikoi dy dobësi dhe bëri rekomandimet përkatëse, si dhe bëri një pohim. Karakteristika e praktikës së mirë ka të bëjë me lidhjet e forta dhe gjithëpërfshirëse me përfaqësuesit e sektorit privat, të cilët janë në gjendje të mbështesin Akademinë "Ivodont" në përfitim të studentëve. Dobësitë lidhen me mungesën e kompetencës së gjuhës së huaj dhe mobilitetin e ulët të studentëve. Rekomandimet përkatëse sugjerojnë rritjen e mobilitetit të

studentëve dhe përfshirjen e kompetencës së gjuhës së huaj në program. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon përpjekjet e Akademisë për të hartuar dosjen e aplikimit për krijimin e një programi Master.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një dobësi dhe bëri rekomandimin përkatës, si dhe bëri një pohim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi. Dobësitë lidhen me mungesën e prioriteteve të mirëpërcaktuara kërkimore, fushave/temave të qarta kërkimore dhe grupeve të kërkimit. Rekomandimi përkatës është të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për të bërë të mundur dhe inkurajuar stafin që të bashkëpunojë, të përcaktojë prioritete të qarta kërkimore dhe fusha shkencore dhe të punojë vazhdimisht për të ndjekur këto prioritete kërkimore institucionale. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim aktualisht në proces për këtë Fushë Vlerësimi, me përjashtim të një Strategjie Zhvillimi 2018-2023, por që i mungojnë veprimet konkrete.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, identifikoi tri dobësi dhe bëri rekomandimet përkatëse. Dobësitë lidhen me mungesën e politikës së informacionit dhe veprimeve për shkollën e mesme; mungesën e infrastrukturës së posaçme për studentët me aftësi të kufizuara; përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese. Rekomandimet përkatëse kanë të bëjnë me hartimin e një politike për informimin dhe orientimin e nxënësve të shkollës së mesme lidhur me AI-në dhe programin e studimit, si dhe organizimin e fushatës orientuese për shkollat e mesme; përmirësimin e infrastrukturës për studentët me aftësi të kufizuara; përfaqësimin gjithëpërfshirës të studentëve në strukturat ose organet drejtuese të AI-së. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi veprime aktualisht në proces lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Akademia kreu vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e ASCAL-së. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson nivelin e angazhimit të Akademisë me këtë proces dhe bashkëpunimin e saj me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm gjatë fazës së vizitës. Konkretisht, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përgëzon punën e Grupit të Vetëvlerësimit për mundësimin e një baze gjithëpërfshirëse evidencash dhe Koordinatorin Institucional për vëmendjen ndaj Grupit të Vlerësimit të Jashtëm përgjatë vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Anila Hoda (Kryetare) dhe Hemion Braho (Ekspert Vlerësues i Jashtëm).

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Lidhjet e forta dhe gjithëpërfshirëse me përfaqësuesit e sektorit privat, të cilët janë në gjendje të mbështesin AI-në në interes të studentëve **(Kapitulli I, Standardi I.12)**

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Debati i brendshëm nuk ndodh në të gjitha nivelet drejtuese **(Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi I.4, Kapitulli III, Standardi II.3).**
- Procedurat e komunikimit ndërmjet Senatit dhe Bordit të Administrimit nuk janë të qarta. **(Kapitulli III, Standardi I.2)**
- Lidhur me zhvillimin e stafit, nuk ka praktika apo procedura të konsoliduara për aksesimin e fondeve për këtë qëllim ose politika informuese **(Kapitulli III, Standardi IV.2).**
- Departamentet nuk kanë procedurë standarde për vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të stafit **(Kapitulli III, Standardi IV. 3)**
- Përfshirje e kufizuar e departamenteve dhe Fakultetit në hartimin e buxhetit **(Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2)**
- Akademia “IVODENT” nuk ka një sistem qendror për drejtimin institucional **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**
- Programi Bachelor nuk ka kompetencë të gjuhës së huaj **(Kapitulli I, Standardi I.10)**
- Mungesa e kompetencës së gjuhës së huaj ndikon mobilitetin e ulët të studentëve **(Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.3; Kapitulli I, Standardi I.6).**
- Kërkimi kryhet në nivel individual. **(Kapitulli II Standardi I.4)**
- Mungojnë prioritetet e mirëpërcaktuara kërkimore, fushat/temat e qarta kërkimore dhe grupet e kërkimit **(Kapitulli II Standardi I.5)**
- Mungon politika e informacionit dhe veprimet për shkollën e mesme. **(Kapitulli I, Standardi III.1).**
- Mungon infrastruktura e posaçme për studentët me aftësi të kufizuara **(Kapitulli I, Standardi III.4).**
- Një dobësi tjetër është mungesa e përfaqësimit gjithëpërfshirës të studentëve në organet drejtuese **(Kapitulli I, Standardi III.7).**

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- drejtuesit e Akademisë të sigurojnë krijimin e një ambienti konstruktiv që mundëson debatin dhe diskutimin gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet formale të qeverisjes dhe drejtimit të Akademisë, me qëllim sigurimin e nivelit të duhur të qartësisë **(Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi I.4, Kapitulli III, Standardi II.3)**
- Standardizimi i procedurave të komunikimit ndërmjet Senatit dhe Bordit të Administrimit për rritjen e transparencës **(Kapitulli III, Standardi I.2)**

- Ngritja e mekanizmave për ofrimin e mbështetjes financiare për stafin në kuadër të veprimtarive të zhvillimit dhe krijimi i procedurave standarde për këtë qëllim. **(Kapitulli III, Standardi IV.2)**
- Hartimi i buxhetit duhet të jetë një proces 'nga poshtë lart' ku departamentet i paraqesin fakultetit propozimet për shpenzimet. **(Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2)**
- Buxheti i miratuar duhet të publikohet në faqen e internetit dhe të gjithë pjesëtarët e stafit akademik duhet të informohen në mënyrë individuale **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**
- Vendosja e praktikës së mirë nëpërmjet kontrollit të jashtëm financiar. **(Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2)**
- Ngritja e një sistemi qendror për drejtimin institucional **(Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2)**
- Rritja e mobilitetit të studentëve dhe përfshirja e kompetencës së gjuhës së huaj në program. **(Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.3; Kapitulli 1, Standardi 1.6).**
- AI duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të bërë të mundur dhe inkurajuar stafin që të bashkëpunojë, të përcaktojë prioritete të qarta kërkimore, fusha shkencore dhe të punojë vazhdimisht për të ndjekur këto prioritete kërkimore institucionale. **(Kapitulli II Standardi I.5)**
- Hartimi i një politike për informimin dhe orientimin e nxënësve të shkollës së mesme lidhur me AI-në dhe programin e studimit, si dhe organizimin e fushatës orientuese për shkollat e mesme. Përmirësimi i infrastrukturës për studentët me aftësi të kufizuara dhe përfaqësimi gjithëpërfshirës i studentëve në strukturat ose organet drejtuese të AI-së. **(Kapitulli I, Standardi III.1; Kapitulli I, Standardi III.4; Kapitulli I, Standardi III.7)**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- Angazhimi i Akademisë për ofrimin e një game më të gjerë dokumentacioni rregullator dhe procedural **(Kapitulli III, Standardi I.6)**
- Akademia po harton dosjen e aplikimit për krijimin e një programi Master **(Kapitulli I, Standardi I.9).**
- Strategjia e Zhvillimit 2018-2023, por mungojnë veprimet konkrete. **(Kapitulli II Standardi I.5)**

Përmbledhje e gjytimeve për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Drejtimin e tij janë **përbushur pjesërisht.**
2. Standardet për Burimet janë **përbushur pjesërisht.**
3. Standardet për Kurrikulën janë **përbushur kryesisht.**
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht.**
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht.**

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Bordit të Akreditimit se në Akademinë “Ivodont”, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përmbushur kryesisht**.

Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Drejtimi i tij

- 1.1 Që prej hapjes së tij, ky Institucion ka ofruar vetëm studim të ciklit të parë në nivelin Bachelor në degën “Teknikë e Lartë Dentare”. Sikurse u konfirmua në takimin me Rektoren, fillimisht Institucioni kishte një orientim të theksuar drejt të qenit “shkollë profesionale”. Më pas, në vitin 2013, pas vlerësimit austriak, 3 komponentë, që ishin biznesi, shkollat dhe stazhet, shërbyen si bazë për ngritjen e Institucionit. Në vitin 2014 pati një pezullim të veprimtarive të Akademisë “Ivodent” (AI) për papajtueshmëri me kërkesat ligjore të ligjit, konkretisht me numrin e Profesorëve të kërkuar nga ligji (Vendim i Kryeministrit Nr. 540, datë 06.08.2014). **(Kapitulli III, Standardi I.1)**
- 1.2 Për këtë, AI rishikoi aktet rregullatorë bazë të Institucionit, duke miratuar një Statut të ri **[I.1 Statuti AI]**, Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit **[I.4 Rregullorja e AI]** dhe aktet rregullatorë vijues, të tillë si rregulloret lidhur me Departamentet dhe programet e studimit. Gjatë vizitës, procesi i miratimit për Statutin e rishikuar të Akademisë i konfirmoi ASCAL-së që Senati Akademik kishte miratuar Statutin e rishikuar **[I.6. Vendim Senati për miratim aktesh rregullatorë]**. Të gjithë aktet rregullatorë rishikohen vazhdimisht. **(Kapitulli III, Standardi I.1)**
- 1.3 Akademia “Ivodent” është një Institucion me përmasa të vogla, për sa i përket numrit të studentëve dhe infrastrukturës. Pavarësisht kësaj, ajo është organizuar në mënyrë që të sigurojë efikasitetin drejtues në përputhje me kërkesat legjislative **[I.19, I.20 Organigrama e AI]** Rrjedha e informacionit nga departamentet te Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, dhe qarkullimi i vendimeve të marra nga to drejt stafit dhe studentëve është efikas **[I.9, I.10 Rregullore e Rektorit dhe Senatit Akademik]**. Marrëveshjet për drejtimin dhe administrimin e Akademisë, dhe vendimmarrjen kolegjiale, kanë parasysh kërkesat ligjore dhe kuptohen nga stafi në të gjitha nivelet **[I.16 Rregullore e Bordit të Administrimit]**. **(Kapitulli III, Standardi I.2)**
- 1.4 Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se institucioni zhvillonte debate, por nuk u vërejtën përfitime të qarta. Takimet e Senatit duhet të shërbejnë si një mundësi për të siguruar drejtimin efikas në organet drejtuese të Akademisë. Në këtë mënyrë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vërejtë se kjo klimë bashkëpunimi dhe kooperimi ndërmjet organeve kolegjiale të Akademisë, në veçanti Senatit dhe Bordit të Administrimit, është e drejtpërdrejtë dhe e sinqertë, duke krijuar një ambient në të cilin studentët dhe stafi që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm shprehën vlerësim pozitiv dhe kënaqshmëri. **[I.10 Rregullore e Senatit Akademik; I.15 Procedurë Rregullatore e Senatit Akademik]** Sikurse u referua gjatë vizitës, këto mekanizma komunikimi pozitiv bëhen të mundura nga përmasat e vogla të Institucionit. Megjithëse, me sa duket, pjesëtarët e së njëjtës familje mbajnë pozicionet kyçe drejtuese në Akademi dhe pavarësisht dobësive të identifikuara, me qëllim përmirësimin dhe fuqizimin e proceseve të vendimmarrjes të Institucionit, rekomandohet që drejtuesit e lartë të tregohen të vëmendshëm për të siguruar krijimin e një ambienti të harmonizuar, mbështetës dhe produktiv, që bën të mundur që debati dhe diskutimi në të gjitha bordet dhe komitetet e krijuara formalisht të zhvillohen në mënyrë profesionale dhe kolegjiale në përputhje me kërkesat e ligjit, duke garantuar kështu qeverisjen efikase dhe drejtimin e Akademisë “Ivodent”. **(Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi I.4, Kapitulli III, Standardi II.3).**

- 1.5 Akademia ka zhvilluar një komunikim të mirë me palët e brendshme të interesit, duke ndërtuar marrëdhënie pozitive. Institucioni siguron që të respektohen kufijtë e autonomisë së vet dhe që të funksionojë brenda kufijve të legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi **[I.4 Rregullore e AI]**. Me qëllim përmbushjen e detyrimeve vjetore, një grup pune i ngritur nga Rektori përgatit raporte analitike të posaçme për veprimtarinë vjetore të Akademisë **[I.43; I.44 Raportet Analitike 2017-2019]**. Marrëveshjet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse, dhe për të mbështetur diskutimet dhe debatet kolegjiale kuptohen nga stafi dhe studentët. Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve janë përgjegjës për monitorimin vendor të zbatimit të vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e krijuara formalisht. Këto raporte mundësojnë një komunikim më të mirë me MASR-në, si dhe raportimin vjetor **[I.27, I.28]**. Që prej vitit 2015, Akademia ka qenë nën monitorim të vazhdueshëm pas pezullimit në vitin 2015. **(Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.VI)**
- 1.6 Komiteti i Sigurimit të Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë dy struktura bashkëpunuese që luajnë rol strategjik në monitorimin dhe analizimin e efikasitetit të veprimtarive të vlerësimit të brendshëm **[I.4 Rregullore e AI, Neni 15]**. Njësia përbëhet nga përfaqësues të ndryshëm institucionalë nga Akademia dhe ka për detyrë rritjen institucionale. Anëtarët e njësisë luajtën rol kyç që nga momenti i pezullimit, gatë momentit të riorganizimit, si dhe në marrëveshjen e lidhur me MASR **[I.29 Verifikimi i Kapaciteteve nga MASR]**. Vlerësimi konstatoi se përmasat e vogla të Institucionit kanë formalizuar disa nga veprimet e Njësisë në rregullore, por njëkohësisht i kanë përshtatur ato me nevojat e Institucionit. Në këtë aspekt, Akademisë i duhet të tregojë kujdes që të mos transformojë strukturat e saj të Cilësisë në përfaqësim formal. Megjithatë Akademia i fton konsulentët e jashtëm akademikë të marrin pjesë në zhvillimin e Institucionit, konsulentët e jashtëm nuk kanë qenë të përfshirë në zhvillimin e procedurave që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë. **(Kapitulli III, Standardi I.4)**
- 1.7 Akademia ka miratuar një Strategji të posaçme të Zhvillimit Institucional për periudhën 2018-2023, që është miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit **[I.21 Strategjia e Zhvillimit të Institucionit 18-23]**. Strategjia u zhvillua nga një grup pune i posaçëm, anëtarët e së cilit u miratuan nga Senati Akademik. Studentët dhe stafi konfirmuan që konsultimet mbi Strategjinë u zhvilluan nëpërmjet vënies në dispozicion të draft dokumentit në faqen e internetit të Akademisë. Institucioni ka parashikuar përfshirjen e disa partnerëve në strategjinë e vet të zhvillimit **[I. 33, I. 34, I.35, I. 36 Partnerët]**. Bashkëpunimi me partnerët ka bërë të mundur që Institucioni të mbledhë të gjithë informacionin e rëndësishëm dhe të zhvillojë një studim tregu **[I.40 Studimi i Tregut]**. Miratimi i Strategjisë së Zhvillimit 2018-2023 dhe Studimi i Tregut treguan se Akademia ka ndërmarrë veprime për adresimin e plotë të dobësive të identifikuara pas periudhës së pezullimit. **(Kapitulli III, Standardi I.5)**
- 1.8 Akademia “Ivodont” ka nënshkruar marrëveshje të shumta me partnerë nga fusha e biznesit dhe homologë në sektorin përkatës. Si rrjedhojë, Institucioni ka zhvilluar lidhje të mira me tregun dhe iu ka ofruar stafit dhe studentëve mundësinë për të marrë pjesë në aktivitete të jashtme edhe në nivel ndërkombëtar **[I.30, I.31, I.32]**. Stafi drejtues njih vlerën e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në aktivitete ndërkombëtare dhe e ka përfshirë këtë temë si një komponent kyç të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit 2018-2023 **[I.21]**. Studentët dhe stafi konfirmuan se Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare publikon informacion në faqen e internetit të Akademisë lidhur me aktivitetet ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve. Stafi

drejtues u shpreh se publiciteti i shtuar ndaj mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve u konsiderua i suksesshëm pasi pati tre ose katër aplikime për çdo vend të disponueshëm për stafin ose studentët. Në planet vjetore mbi veprimtarinë dhe raportet vjetore, bashkëpunimet dhe partneritetet kanë një rol të konsiderueshëm në prioritetet e institucionit **[I.43, I.44 Planet Vjetore]. (Kapitulli III, Standardi I.6)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Debati i brendshëm nuk sigurohet në të gjitha nivelet drejtuese (Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi I.4, Kapitulli III, Standardi II.3).
- Procedurat e komunikimit ndërmjet Senatit dhe Bordit të Administrimit nuk janë të qarta. (Kapitulli III, Standardi I.2)

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- drejtuesit e Akademisë të sigurojnë krijimin e një ambienti konstruktiv që mundëson debatin dhe diskutimin gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet formale të qeverisjes dhe drejtimit të Akademisë, me qëllim sigurimin e nivelit të duhur të qartësisë. (Kapitulli III, Standardi I.1; Kapitulli III, Standardi I.2; Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi I.4, Kapitulli III, Standardi II.3).
- Standardizimi i procedurave të komunikimit ndërmjet Senatit dhe Bordit të Administrimit për rritjen e transparencës **(Kapitulli III, Standardi I.2)**

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- Angazhimi i Akademisë për ofrimin e një game më të gjerë dokumentacioni rregullator dhe procedural

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Drejtimin janë përmbushur pjesërisht.

Fusha e vlerësimit 2: Burimet

2.1 Struktura organizative e AI-së diskutohet dhe miratohet nga Senati Akademik dhe nga Bordi i Administrimit. **[I. 20 Organigrama dhe personeli]**. Procedurat transparente janë të përcaktuara dhe bëhen publike në faqen e internetit të Akademisë. **[www.ivodent.edu.al]** Strukturat përkatëse përcaktojnë përgjegjësitë për administrimin e burimeve për të përmbushur kërkesat e Standardeve Shtetërore të Cilësisë. **[I.1 Statuti; I.4 Rregullore e AI]** Sikurse u mësua gjatë vizitës, kriteret e punësimit për secilin pozicion pune vakant përcaktohen në Statut dhe departamentet lejohen të shtojnë kriteret të tjera nëse miratohen nga Rektori. **[I.4 Rregullore e AI]**. Stafi me kohë të pjeshme punësohet sipas nevojave mësimore dhe kërkimore të departamenteve. Kriteret për përzgjedhjen e stafit dhe procedurat e rekrutimit përcaktohen në Rregulloret e Akademisë. **[I.4 Rregullore e AI]** Procedurat për punësimin e stafit mësimdhënës, shkencor dhe administrativ ndjekin të njëjtin proces, që bazohet në pjesët përkatëse të Statutit, Rregulloreve dhe ligjit në fuqi. Gjatë viteve, Akademia ka punësuar një sërë pjesëtarësh të stafit akademik nga universitete të njohura ndërkombëtarisht, dhe stafi akademik pritet të ketë një farë përvojë nga një Akademi perëndimore. Strategjia e Zhvillimit të Akademisë përcakton se tërheqja e stafit akademik dhe studentëve të huaj është një nga objektivat. **[I. 21 Strategjia e Zhvillimit të Institucionit]** Stafi mësimdhënës u shpreh se disa profesorë vijnë nga jashtë vendit dhe kanë një sërë lëndësh që mund të zhvillohen në gjuhën angleze prej tyre dhe Akademia ka qenë më aktive gjatë vitit në publikimin e aplikimeve të mobilitetit. **[I.50 Statistika]**. Akademia mundëson një strukturë administrative si në nivelin e Akademisë, po ashtu dhe në atë të fakultetit, duke ofruar shërbime sipas nevojës. (Kapitulli III, **Standardi IV.1; Kapitulli III, Standardi II.2; Kapitulli III, Standardi VII.6**).

2.2 Në përputhje me Statutin dhe misionin e saj, Akademia "Ivodent" garanton autonomi dhe liri akademike për të gjithë stafin akademik, të harmonizuar me objektivat dhe programet kurrikulare. **[IV.5 Lista e Aktiviteteve dhe Kërkimeve]** Akademia ka një politikë në mbështetje të trajnimit dhe zhvillimit të stafit, por nuk ka praktika ose procedura të konsoliduara për aksesimin e fondeve ose politikat informuese për këtë qëllim **[IV.8 Trajnimet]**. Nëse stafi akademik është i angazhuar në aktivitete të jashtme, ata kanë të drejtën të rikthehen në pozicionin e tyre të punës më pas. Në nivel të brendshëm, stafi angazhohet në workshop-e, ditë informuese, evente promovuese dhe aktivitete sociale, të organizuara nga Akademia. Informacioni i ofruar është po ashtu i rëndësishëm për politikën e përfshirjes. Në veçanti, Ditët e Hapura, që lidhen ngushtësisht me fillimin e secilit vit akademik, e përcjellin informacionin nëpërmjet përfshirjes së stafit, si administrativ dhe akademik, të studentët dhe kandidatët **[V.7;V.8;V.9;V.10 Politikën e Informimit]** (Kapitulli III, **Standardi IV.2**)

2.3 Strategjia e Zhvillimit e AI-së fokusohet në tre fusha kryesore; mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe trajnimet. **[RVV fq.19]** Si rezultat i orientimit të Akademisë drejt aftësive praktike, trajnimet kanë qenë fokusi kryesor, veçanërisht në konferencat shkencore me institucionet homologe në Evropë; konferencat e organizuara në fushën mjekësore në koordinim me Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim **[IV.1 Lista e Botimeve; IV.2 Lista e Mobilitetit]**. Në këtë aspekt, Përgjegjësit e Departamenteve duhet të vendosin objektiva për stafin çdo vit, në përputhje me rolet e tyre, dhe në fund të vitit duhet të vlerësohet performanca e pjesëtarëve të stafit. Për këtë arsye, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm thekson rëndësinë e zbatimit të një procedure të hollësishme, të konsoliduar dhe standarde

për vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të stafit. Akademia ka mundësinë që të marrë pjesë në trajnime në institucione ndërkombëtare në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruara të bashkëpunimit. Duhet të merret në konsideratë dhe mundësia për t'i dhënë mbështetje financiare stafit në kuadër të këtyre aktiviteteve. Sikurse u pohua gjatë vizitës, Akademia ndjek një praktikë që fton profesorë dhe profesionistë të huaj për të dhënë leksione në Akademi. **[RVV fq. 20] (Kapitulli III, Standardi IV. 3)**

2.4 Ndër synimet e AI-së është dhe mbështetja sociale për aktivitetet për stafin dhe studentët në mënyrë vullnetare në ndihmë të kategorive sociale në nevojë konsiderohet me rëndësi për institucionin **[V.3; V.4; V.5 Aktivitetet Sociale]**. Akademia duhet të promovojë më shumë dialogun, duke përfshirë stafin në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe konsultimit. Akademia zbaton kuadrin ligjor për sigurimin shoqëror dhe të shëndetit dhe paguan detyrimet e veta në përputhje me Kodin e Punës dhe dispozitat në kontratat individuale të punës. **[RVV fq. 20; II.11 Shembull kontrate pune](Kapitulli III, Standardi IV.4)**

2.5 Akademia siguron mbështetjen e nevojshme për zyrat administrative që mbulojnë burimet njerëzore të institucionit. Zyra e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është struktura administrative koordinuese e posaçme për këtë qëllim. Dokumentet përkatëse ruhen në arkivin e Zyrës së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në përputhje me ligjet dhe statutin **[II.4 Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit]**. Kjo zyrë kryen dhe detyra monitoruese sipas kërkesave të ligjit dhe Kodit të Etikës. **(Kapitulli III, Standardi II.2)**

2.6 Akademia ka pavarësi financiare në hartimin e buxhetit në përputhje me Statutin **[RVV fq. 21]**. Në çdo rast, për të garantuar qëndrueshmëri financiare sipas nevojave akademike, hartimi i buxhetit duhet të jetë një proces 'nga poshtë lart', ku departamentet i paraqesin fakultetit propozimet për shpenzimet. Përmasat e vogla të Institucionit dhe lidhjet e mundshme familjare mund të përbëjnë rrezik për cenimin e autonomisë dhe vendimmarrjes së lirë. Gjatë vizitës, u konfirmua që Administratori është përgjegjës për hartimin e projektbuxhetit sipas Strategjisë së Zhvillimit **[I.42 Relacioni Financiar i Administratorit]**. Administratori dhe Bordi i Administrimit mbikëqyrin dhe kontrollojnë menaxhimin financiar dhe sigurojnë pajtueshmërinë me rregullat e kontabilitetit. Më pas, projektbuxheti përfundimtar dorëzohet për diskutim dhe miratim në Bordin e Administrimit. Më pas, buxheti dhe raporti financiar i dorëzohen MASR-së. **[I.27; I.28 Raportet ndaj MASR]**. Referuar akteve të brendshëm rregullatorë, Akademia ka procedura transparente për administrimin e burimeve financiare dhe zbaton kërkesat ligjore. Në përputhje me politikat e transparencës, buxheti i miratuar duhet të publikohet në faqen e internetit dhe të gjithë pjesëtarët e stafit akademik duhet të informohen në mënyrë individuale. **(Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2)**

2.7 Që prej periudhës së pezullimit, Institucioni ka qenë nën monitorim të vazhdueshëm financiar dhe MASR-së i raportohet vazhdimisht informacioni financiar **[I.27; I.28 Raportet financiare ndaj MASR]**. Sikurse u raportua gjatë vizitës, Akademia nuk i është nënshtruar ndonjë kontrolli të posaçëm financiar, qoftë të jashtëm apo të brendshëm, por institucioni është subjekt i kontrollove të mundshme në përputhje me ligjin. **(Kapitulli III, Standardi VI.3)**

2.8 Për shkak të përmasave të vogla, AI-ja nuk ka një sistem qendror të drejtimit institucional. Kjo është një nga objektivat e "strategjisë së zhvillimit". **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**

2.9 Infrastruktura e TI-së e Akademisë është funksionale dhe e disponueshme në të gjithë mjediset e fakultetit, duke pasur një gamë të gjerë mbështetjeje kompjuterike për

përdorim nga studentët, së bashku me softuerët përkatës. **[RVV fq.24]** Stafi dhe studentët u shprehën se kompjuterët dhe softuerët e mundësuar nga Akademia janë të përshtatshëm për nevojat e tyre **[II.13 Raporti mbi infrastrukturën]. (Kapitulli III, Standardi VII.2)**

2.10 Akademia ka regjistër të pasurive të paluajtshme **[RVV fq.24]**. Ajo monitoron nga afër përdorimin e burimeve sipas kërkesave për veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimit. **[II.13 Raporti mbi infrastrukturën]**. Akademia i përmbush kriteret e përcaktuara në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë **[II.5; II.6 Planimetria]**. Akademia zotëron salla mësimdhënieje, laboratorë, mjedise për stafin administrativ dhe mësimdhënës, biblioteka dhe salla kompjuterësh. Infrastruktura dhe logjistika menaxhohen në përputhje me statutin dhe rregulloret përkatëse. **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5)**

2.11 Zyra e Protokollit përdoret për ruajtjen e kopjeve fizike të dokumenteve **[II.4 Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit]**. Të dhënat statistikore mblidhen nga Sekretaria e Informacionit dhe Mësimore dhe i raportohen Ministrisë çdo vit **[II.1 Rregullore e Sekretarisë mësimore]**. Sekretaria është përgjegjëse dhe për mbajtjen e regjistrave, si regjistri i studentëve, regjistrimet, dhe notat e studentëve **[RVV, fq. 27]. (Kapitulli III, Standardi V.2)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Lidhur me zhvillimin e stafit, nuk ka praktika apo procedura të konsoliduara për aksesimin e fondeve për këtë qëllim ose politika informuese (Paragrafi 2.2; Kapitulli III, Standardi IV.2).
- Departamentet nuk kanë procedurë standarde për vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të stafit (Paragrafi 2.3; Kapitulli III, Standardi IV. 3)
- Përfshirja e departamenteve dhe Fakultetit në hartimin e buxhetit është e kufizuar (Paragrafi 2.6; Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2)
- Akademia "IVODENT" nuk ka një sistem qendror për drejtimin institucional (Paragrafi 2.6, Kapitulli III, Standardi VII.1).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Ngritja e mekanizmave për ofrimin e mbështetjes financiare për stafin në kuadër të veprimtarive zhvillimore dhe krijimi i procedurave standarde për këtë qëllim.

- Hartimi i buxhetit duhet të jetë një proces 'nga poshtë lart', ku departamentet i paraqesin fakultetit propozimet për shpenzimet.
- Buxheti i miratuar duhet të publikohet në faqen e internetit dhe të gjithë pjesëtarët e stafit akademik duhet të informohen në mënyrë individuale.
- Vendosja e praktikës së mirë nëpërmjet kontrollit të jashtëm financiar.
- Ngritja e një sistemi qendror për drejtimin institucional.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi veprime aktualisht në proces lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur pjesërisht.

Fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Akademia ofron një program studimi 3-vjeçar të nivelit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” [RVV fq. 29]. Detajet mbi programin, si për shembull synimet, objektivat, struktura e lëndëve dhe vlerat e krediteve janë të disponueshme në faqen e internetit të Al-së në adresën [www.ivodent.edu.al]. Synimi i këtij programi Bachelor është të trajnojë dhe të përgatisë studentët për tregun e stomatologjisë, në përputhje me përvojën e fituar gjatë viteve nga Akademia dhe njohuritë e përfuara nga bashkëpunimi i jashtëm [I.4 Rregullore e AI]. Studentët pohuan se kanë akses në të gjithë informacionin e programit që iu nevojitet, si para dhe gjatë studimeve, drejtpërdrejt dhe nëpërmjet faqes së internetit. Programi i studimit është zhvilluar sipas prioriteteve të identifikuara në Strategjinë e Zhvillimit, dhe kërkesat për kualifikimin e studentëve përshkruhen në objektivat e Strategjisë së Zhvillimit. [I.21 Strategjia e Zhvillimit të Institucionit ‘18- 23]. Programi i studimit është gjithëpërfshirës dhe përcakton se çfarë do të jetë i aftë studenti të bëjë pas diplomimit. [III.2 Rregullore për programin e studimit]. Studentët pohuan se janë në dijeni të kësaj dhe se kanë përfutur prej saj. Të diplomuarit pajisjen me një suplement diplome që përcakton nivelin, përmbajtjen dhe notat e arrira nga studenti [V.7; V.8 Politika për studentët]. Akademia bashkëpunon me Ministrinë lidhur me kurrikulën e shkollës së mesme dhe fakulteti organizon “Ditët e Hapura”, për t’iu dhënë nxënësve të shkollave të mesme informacion mbi programin e studimit, kurrikulat, stafin akademik, infrastrukturën mësimore mbështetëse dhe fushat e mundshme të punësimit në të ardhmen [V.7; Manuali i Këshillimit të Karrierës]. Mbulimi i studentëve, në shumicën e rasteve, është një proces i vazhdueshëm në AI, që fillon me periudhën e aplikimit dhe regjistrimit dhe vazhdon përgjatë studimeve të tyre me këshillime rreth karrierave të mundshme [RVV, fq. 30]. (Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.3; Kapitulli 1, Standardi 1.6).

3.2 Programi i ofruar është me kohë të plotë [I.45 Dosja e Programit të Studimit]. Krahas kësaj, për qëllime të certifikimit dhe akreditimit janë përcaktuar dhe trajnime dhe evente [IV.21 Programet profesionale]. Institucioni është i vëmendshëm ndaj nevojave të studentëve, ndaj oraret mësimore janë përshtatur për të marrë në konsideratë kërkesat e studentëve. (Kapitulli I, Standardi I.2).

3.3 Programi i studimit Bachelor në Shkenca është hartuar në përputhje me procesin e Bolonjës për sa i përket strukturës, nivelit dhe vlerës së krediteve, dhe është i harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020) dhe i koordinuar me MASR [RVV, fq 31-32]. Modulet vlerësohen në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) që rezultojnë në 180 kredite gjithsej pas tre vitesh [III.2 Rregullore për programin e studimit]. Programi Bachelor në Shkenca në “Teknikë të Lartë Dentare” është i orientuar sipas njohurive dhe aftësive praktike të bazuara në Udhëzimet e MASR-së dhe sipas praktikave më të mira evropiane. Akademia, në përputhje me “udhëzimet për zhvillim”, është e angazhuar në përfshirjen e palëve të ndryshme të interesit, si stafi akademik, specialistë të fushës, institucionet homologe dhe përfaqësuesit e bizneseve, me qëllim përmirësimin e kurrikulave dhe identifikimin e nevojave të tregut të punës [I.21 Strategjia e Zhvillimit të Institucionit] (Kapitulli I, Standardi I.4).

3.4 Aktualisht, Akademia ofron vetëm një program Bachelor, ndaj shpërndarja e burimeve mësimore është e lehtë nga ana sasiore. Përvoja në mësimdhënie dhe nevojat e Institucionit janë kriteret bazë për caktimin e moduleve mësimore [RVV, fq. 32]. Kapaciteti i

Akademisë lidhur me infrastrukturën, plotësimin me staf dhe financat merren në konsideratë për të përmbushur nevojat akademike të AI-së, veçanërisht për sa u përket aftësive praktike të nevojshme që lidhen me programin. Departamenti i harton planet mësimore në bazë vjetore, sipas akteve aktuale nënligjore, dhe në fund të vitit raporton lidhur me performancën kundrejt objektivave të planit **[III.4 Plani mësimor]**. Mësimdhënia shtesë nga stafi me kohë të plotë ose të pjesshme nuk është e parashikuar. **(Kapitulli I , Standardi I.5).**

3.5 Nëpërmjet zhvillimit të programit Bachelor në “Teknikë të Lartë Dentare”, Akademia synon të pajisë studentët me njohurinë bazë, aftësitë e përgjithshme analitike dhe aftësitë e posaçme që nevojiten për punësim ose për përparim në nivelin Master **[I.45 Dosja e Programit të Studimit]**. Programi organizohet në mënyrë të tillë që t'i përgatisë dhe t'i bëjë studentët të aftë për punësim ose studim në fusha të tjera me interes **[RVV fq. 33]**. Akademia ofron mundësi për transferimin e krediteve ndërmjet programeve të të njëjtit nivel në institucione të tjera të arsimit të lartë. Studentëve iu jepet informacion lidhur me mundësitë pas diplomimit dhe të dhëna praktike për njohjen dhe vërtetimin e diplomës në vend dhe jashtë **[V.9; V.10 Broshurë informacioni]**. Studentët pohuan se programi Bachelor i përgatit ata për punësim dhe për përparimin gradual drejt nivelit të studimeve Master jashtë AI-së. **(Kapitulli I , Standardi I.7).**

3.6 Studentët u shprehën se Akademia ofron mbështetje të mirë që iu mundëson të familjarizohen me mjediset e Akademisë. Studentëve iu ofrohet mbështetje për shërbimet e AI-së dhe këshillim karriere nga sekretaria mësimore **[II.1 Rregullore e Sekretarisë mësimore]**. Fakulteti dhe departamentet, zyra e TI-së, dhe stafi i bibliotekës ofrojnë mbështetje të përditshme për studentët gjatë studimeve të tyre **[V.7; V.8 Politikat e këshillimit të karrierës]**. Sikurse u pohua gjatë vizitës, Akademia i jep prioritet punësimit të stafit akademik me profil të mirë kërkimor si në Shqipëri, po ashtu edhe jashtë saj. Në përputhje me kërkesat ligjore dhe marrëveshjen e posaçme me MASR-në, stafi akademik me kohë të plotë mbulon më shumë se 70 për qind të ngarkesës mësimore në programin Bachelor **[RVV, fq. 34]**. **(Kapitulli I , Standardi I.8).**

3.7 Akademia nuk ofron program studimi të ciklit të dytë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u bë me dije se AI-ja po vlerëson nevojat e tregut dhe po harton dosjen e aplikimit për MASR **[RVV, fq. 35]**. **(Kapitulli I , Standardi I.9).**

3.8 Programet e studimit janë bashkërenduar me procesin e Bolonjës dhe vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), kreditet e përfuara në Akademi dhe jashtë vendit njihen në Rregullore **[III.2 Rregullore për programin e studimit]**. Një student me kohë të plotë përfiton 60 kredite në vit. Suplementi i Diplomës pas përfundimit të studimeve lëshohet në gjuhën shqipe. Programi Bachelor nuk ka kompetencë të gjuhës së huaj, por institucioni deklaroi se do të plotësojë dokumentacionin për këtë qëllim **[RVV, fq. 35]**. **(Kapitulli I , Standardi I.10).**

3.9 Integrimi i zbatimit praktik dhe njohurive teorike në programet e studimit arrihet përmes rasteve studimore, punës laboratorike, detyrave praktike dhe projekteve, praktikës profesionale dhe temës përfundimtare ose projektit kërkimor **[IV.5; IV.6; IV.7; IV.8; IV.9; IV.10 Kërkimi shkencor]**. Sikurse u deklarua gjatë vizitës, praktikat profesionale ose stazhet, kryesisht në bizneset private, janë të detyrueshme për të gjithë studentët, siç parashikohet në planet mësimore. Tezat e diplomës përdoren po ashtu për të krijuar lidhjen ndërmjet teorisë dhe praktikës dhe rregullat për hartimin e tyre janë të përcaktuara qartë **[RVV, fq. 35-36]**. Studentët marrin pjesë në aktivitete jashtëshkollore të organizuara nga Akademia, ose institucionet homologe, dhe Akademia mundëson mbështetje për to **[IV.10 Lista e lektorëve të ftuar]**. **(Kapitulli I , Standardi I.11; Kapitulli I , Standardi I.12)**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Lidhjet e forta dhe gjithëpërfshirëse me përfaqësuesit e sektorit privat, të cilët janë në gjendje të mbështesin AI-në në interes të studentëve (Kapitulli I, Standardi I.12).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Programi Bachelor nuk ka kompetencë të gjuhës së huaj (Kapitulli I, Standardi I.10)
- Mungesa e kompetencës së gjuhës së huaj ndikon mobilitetin e ulët të studentëve (Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.3; Kapitulli I, Standardi I.6).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Rritja e mobilitetit të studentëve dhe përfshirja e kompetencës së gjuhës së huaj në program.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet aktualisht në proces si më poshtë:

- Akademia po harton dosjen e aplikimit për krijimin e një programi Master

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Programet e studimit bazohen në kuadrin ligjor dhe janë në përputhje me planin akademik **[RVV, fq. 37 dok I.45]**, Nëse është e nevojshme, programet mësimore rishikohen në përputhje me ndryshimet në kuadrin ligjor dhe kërkesat e tregut të punës. Të dhënat janë të publikuara online në faqen zyrtare të Institucionit **[www.ivodent.al]**. Dokumentet ruhen në kopje fizike dhe elektronike **[RVV fq. 37 II.1]**. Programi i studimit Bachelor "Teknikë e Lartë Dentare" dhe përmbajtja e programit mësimor u rishikuan për vitin akademik 2018-2019 **[RVV fq. 37, III.3]**, një proces gjatë të cilit stafi akademik dhe studentët përfshihen në mënyrë aktive [Takim me studentët dhe Takim me stafin akademik]. Studentët japin shembuj se si janë marrë në konsideratë nga Institucioni ndryshimet në kurrikulë të sugjeruara prej tyre.
- 4.2 AI ka në dispozicion disa laboratorë në funksion të programeve të studimit **[RVV, fq. 37, II13 Tur]**.
- 4.3 AI ka nënshkruar disa marrëveshje me kompanitë vendase dhe ndërkombëtare për të mbështetur zhvillimin e stazheve **[RVV fq. 37 - 38, dok I.34, I.35, I.36]**. Stazhi ose praktika profesionale mbikëqyren nga stafi përgjegjës që është një lektor/e e emëruar nga departamenti në përputhje me rregulloret dhe procedurat specifike. **[RVV, fq. 38, Dok IV.3, Takim me stafin akademik]**.
- 4.4 AI ka një bibliotekë të vogël që përmban tekste në shqip dhe gjuhë të huaj në të cilën studentët dhe stafi kanë edhe akses në internet, disa kompjuterë dhe burime online. Biblioteka ka orare hapjeje fleksibël, sipas nevojave të studentëve, të cilët mund edhe të marrin libra hua **[RVV, dok II.13, Tur]**. **[Kapitulli I , Standardi II.1]**
- 4.5 Rregullat dhe kërkesat e provimit iu nënshtrohen rregulloreve institucionale, **[RVV, dok II.1, I.4, III.2]**. Studentët informohen për rregullat e provimit kualifikues përfundimtar ose për mbrojtjen e temës së diplomës. Respektohet anonimiteti. **[RVV fq. 39]** Studentët informohen për rezultatet nga lektori/ja dhe provimet ruhen sipas rregullores **[RVV fq. 40, dok IV.4]**. Ankesat për rezultatin e provimeve dhe procedurat specifikohen në Rregulloren e Fakultetit **[Dok I.8]**. Studentët mund të ankohen nëse dëshirojnë sipas specifikimeve në rregullore **[Dok I.8]**. Vlerësimi përfundimtar varet nga përgatitja e studentit përgjatë vitit **[RVV 39, dok III.2, III.11]** **[Kapitulli I , Standardi II.2]**
- 4.6 Nëse është e nevojshme, programet e studimit rishikohen në përputhje me ndryshimet në kuadrin ligjor dhe kërkesën e tregut të punës, duke marrë në konsideratë propozimet e stafit dhe studentëve **[RVV, fq. 39, dok III.3]**. Në përmirësimin e programit mësimor mund të kontribuojnë edhe Alumnit ose profesionistë të fushës **[RVV fq. 40, dok I.50]**. Do të kryhen analiza vjetore dhe do të përgatiten raporte të detajuara që vlerësojnë mësimdhënien (përfshirë rezultatet e studentit në pyetësorë), aktivitetin hulumtues dhe rezultatet. **[RVV fq. 39; Dok.43; I.44]**. Reagimet e studentëve konsiderohen me kujdes nga stafi dhe Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu komunikua se si balancimi i orëve në laborator dhe detyrave të tjera ka ndryshuar si rezultat i shqetësimeve të ngritura nga studentët. **[Takimi me studentët.]**. **[Kapitulli I, Standardi II.3]**
- 4.7 Respektohet e drejta për liri akademike AI inkurajon dhe mbështet kualifikimin e stafit akademik **[RVV, fq. 40, dok IV.2]**. Gjithashtu, AI fton studiues të huaj në mësimdhënie, kërkim, konferenca, workshop-e, etj. **[RVV, fq. 40, dok IV.10]**. Studiuesit e huaj prezantojnë rezultatet e tyre në konferenca, workshop-e dhe trajnime **[RVV, fq. 40. Dok IV.5, 6, 7, 8, 9]**. AI ofron infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie **[Tur]**, klasa të mirëpajisura me orënditë e nevojshme, akses në internet etj. **[Kapitulli 1, Standardi II.4]**
- 4.8 Institucioni ka ndryshuar statusin nga Kolegj në Akademi. Departamenti është njësi bazë mësimore dhe synon të nxisë, planifikojë, koordinojë, zhvillojë, organizojë dhe

menaxhojë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor siç përcaktohet në Statut dhe Rregullore. Ai nuk ka një fond të veçantë, por merr mbështetje nga Administratori për mjetet e nevojshme, materialin mësimor etj. (dok. I.42). Ai ka një numër të reduktuar të stafit akademik për shkak të numrit të ulët të studentëve, prandaj nuk është e organizuar në grupin e mësimdhënies dhe kërkimit që kërkohet zyrtarisht nga marrëveshja me MASR [dok I.25]

- 4.9 Ai mbështet organizimin e konferencave, simpoziumeve, ditëve të shkencës, workshop-eve ku stafi akademik paraqet kërkimet e tij [dok IV.5, 6, 7]; dhe inkurajon studiuesit të botojnë kërkimet e tyre dhe të marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare përmes prezantimeve në konferenca, ose botimeve në revista shkencore [dok IV.1] [**Kapitulli 2, standardi I.1**].
- 4.10 Ai ofron vetëm një program studimi Bachelor në shkenca. Institucioni ka përgatitur strategjinë e zhvillimit për vitet 2018 - 2023 për kërkimin shkencor [dok I.21], të cilën Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si pohim. Ai inkurajon pjesëmarrjen e stafit akademik në projektin kërkimor, por Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e sheh mungesën e projekteve konkrete si mangësi. [**Kapitulli II Standardi I.2**]
- 4.11 Ai është aktive në promovimin e internacionalizmit të kërkimeve. Ai është bashkë-organizatore e aktiviteteve ose workshop-eve ndërkombëtare, leksioneve të hapura, trajnimeve etj. Është partner i Kongresit të Shoqatës Ballkanike Stomatologjike që nga viti 2019 dhe ka një marrëveshje partneriteti me Institucione të tjera të Arsimit të Lartë [**dok I. 33, 34, 35, 36**]. Por sidoqoftë, vazhdon të ketë mungesë të projekteve kërkimore, fushave ose temave kërkimore. [**Kapitulli II Standardi I.3**]
- 4.12 Ai vendosi prioritetet kryesore për 5 vitet e ardhshme [**RVV fq. 42;**] duke u përqendruar kryesisht tek internacionalizimi. Ai është anëtare e rrjetit të akademisë ndërkombëtare. Ajo ka marrë pjesë në veprimin COST 16112, gjithashtu, ka aplikuar për Programin e Fondit të Ballkanit Perëndimor në 2018, si dhe është partnere dhe mikpritëse e Shoqatës Shqiptare të Kristalografëve. Ai po përpiqet të rrisë profilin ndërkombëtar dhe të zbatojë programe të përbashkëta. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si të nevojshme ngritjen e një profili shkencor, i cili do të kontribuojë më pas në profilin ndërkombëtar. Ai pranon që udhëzimet e kërkimit kanë të bëjnë me aktivitetin kërkimor të stafit akademik (RVV, fq. 43), por Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mendon se kjo veprimtari duhet të organizohet si ekip dhe jo në nivel individual. [**Kapitulli II Standardi I.4**]
- 4.13 Ai është në fillim të zbatimit të strategjisë kërkimore [**RVV fq. 44;**] Kërkimi ndiqet kryesisht nga individë, ka një mungesë të prioriteteve dhe grupeve të mirëpërcaktuara të kërkimit, prandaj Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si një dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Institucioni të marrë të gjithë hapat që përbëjnë prioritete të qarta institucionale, për të përcaktuar ekipet kërkimore që duhet të punojnë për përmbushjen e këtyre prioriteteve. [**Kapitulli II Standardi I.5**]
- 4.15 Ai ka si strategji objektive kërkimin shkencor dhe inovacionin. Por Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e fushave precize të kërkimit si dobësi. [**Kapitulli II Standardi I.6**]
- 4.16 Ai mbështet organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe workshop-e, ku stafi akademik mund të paraqesë kërkimet e tij; disa shembuj përfshijnë pjesëmarrjen në Konferencën e Tretë Kombëtare në "Shkenca të Aplikuara Sociale dhe Humane", ose Kongresi i 24-të i Shoqatës Ballkanike të Stomatologëve. Ai inkurajon edhe pjesëmarrjen e studentëve në konferenca të tilla [**RVV, fq. 44, Dok IV.5**] [**Kapitulli II Standardi I.7**].
- 4.17 Stafi akademik raporton aktivitetin e tij kërkimor në departament dhe më pas ky aktivitet përfaqësohet në analizën vjetore të NjSBC-së. Ai inkurajon dhe mbështet në

mënyrë modeste stafin akademik në kërkime, pjesëmarrje në projekt, prezantime në konferenca dhe botime në revista shkencore. [RVV fq. 45], [Kapitulli II Standardi I.8].

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikave të mira në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një dobësi në këtë Fushë Vlerësimi:

- Kërkimi ndiqet në nivel individual. [Paragrafi 4.12; Kapitulli II Standardi I.4] Ka mungesë të prioriteteve të mirëpërcaktuara të kërkimit, fushave/temave të qarta kërkimore dhe grupeve të kërkimit [Paragrafi 4.13; Kapitulli II Standardi I.5]

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm bëri rekomandime në këtë Fushë Vlerësimi:

- Ai ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme për t'i dhënë mundësinë dhe për të inkurajuar stafin për të bashkëpunuar dhe përcaktuar prioritete të qarta të kërkimit, fushat shkencore dhe për të punuar vazhdimisht për të ndjekur këto përparësi institucionale të kërkimit. [Paragrafi 4.13; Kapitulli II Standardi I.5]

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

- Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi veprime që janë aktualisht në proces në këtë Fushë Vlerësimi, përveç strategjisë së zhvillimit të viteve 2018-2023, por veprimet konkrete mungojnë.

Vendimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e Tyre

- 5.1 Kriteret e pranimit përcaktohen në përputhje me kuadrin ligjor. Kuotat miratohen nga Senati i AI-së **[RVV, f 46, dok. I.11, 12]** Sekretaria mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve dhe transferimin e studimeve. Studentët **konfirmuan [Takim me studentët]** se ishin informuar në lidhje me këtë program studimi përmes mënyrave joformale, nga miqtë e tyre, të cilët kanë studiuar më parë në AI. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si dobësi mungesën e informacionit në shkollat e mesme dhe mungesën e politikës orientuese dhe rekomandon organizimin e fushatës orientuese në shkollat e mesme. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për regjistrimin dhe transferimin e studimeve, sipas rregullores së posaçme **(Dok II.1)[Kapitulli I, Standardi III.1]**
- 5.2 AI ka një zyrë të Shërbimit Studentor **[RVV fq. 46]** e cila është përgjegjëse për informimin dhe komunikimin me studentët për programet e studimit dhe performancën e tyre. I gjithë stafi dhe studentët kanë komunikim të brendshëm dhe të jashtëm. **[RVV f 46; dok II.1, 13]**. AI ruan një dosje për secilin student e cila arkivohet pas diplomimit të studentit sipas ligjit nr. 9154 "Për arkivat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar**[Kapitulli I, Standardi III.2]**
- 5.3 AI ka një numër të vogël studentësh dhe lehtëson kontaktet midis studentëve dhe stafit akademik **[RVV, fq. 47, Takim me studentët, takim me stafin]**. Zyra për mbështetjen e studentëve kujdeset që të informojë studentët në lidhje me akademinë, stafin, rregulloret **[RVV fq. 47]**. AI gjithashtu ka një Manual të Këshillimit të Karrierës **[Dok V.7]**, i cili udhëzon studentët në lidhje me AI-në dhe të drejtat e studentit. Gjithashtu AI mbështet dhe bashkëvepron me studentët në mënyra të ndryshme **[Kapitulli I, Standardi III.3]**
- 5.4 AI synon të sigurojë mbështetje për studentët me aftësi fizike të kufizuara dhe mbështetja financiare është e disponueshme për studentët me aftësi të kufizuara dhe për studentët jetimë ose Romë ose Egjiptianë të Ballkanit **[RVV fq. 48]**. Gjatë turit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zbuloi se nuk ka infrastrukturë të përshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara, gjithashtu studentët duhet të shkojnë në një godinë tjetër për punën laboratorike, ose për në bibliotekë, si rrjedhojë Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si dobësi dhe rekomandon përmirësim të infrastrukturës. Studentët mund të punësohen në disa nga shërbimet e Institucionit dhe të përfitojnë ulje të tarifës së shkollimit **[RVV fq. 48]**. Institucioni deklaron se ka një politikë mbështetëse për studentët të cilët janë të angazhuar në aktivitete të ndryshme sportive **[RVV fq. 48]**, por nuk është e qartë si realizohet kjo. Institucioni deklaron se mbështet financiarisht mjediset sportive të studentëve, por nuk ka prova të qarta. AI ofron një kalendar aktivitete **[V.4, V5]**, ose listë studentësh që kanë marrë pjesë në ndeshjen e minifutbollit **[dok V.3]**. AI ka politika për organizimin e studimeve sipas nevojave të studentëve **[RVV fq. 48][Kapitulli I, Standardi III.4]**
- 5.5 AI pranon se ka një bibliotekë modeste me një hapësirë shumë të vogël **[Tur]** e cila përmban një numër të kufizuar të teksteve në shqip dhe gjuhë të huaj. Institucioni siguron librat shkollorë bazë dhe literaturën plotësuese për studentët, të cilat printohen në sekretari falas. Studentët marrin informacionin e nevojshëm nëpërmjet leksioneve online ose revistave online të ofruara nga stafi. **[Kapitulli I, Standardi III.5]**
- 5.6 AI ka rregullore për funksionimin e sistemit të tutorialit **[dok I.8; I.4 IA; III.2]**. Objektivi i lektorëve kujdestarë është të ndihmojnë dhe mbështesin studentët për të përmirësuar rezultatet e tyre akademike, si dhe për t'i këshilluar ata deri në fund të studimeve. AI ofron vetëm një program që finalizohet me provimin e diplomës, i cili ka një nivel që nuk mbështet kërkimin shkencor. Institucioni organizon leksione të hapura me specialistë të temave të ndryshme**[RVV fq. 49][Kapitulli I Standardi III.6]**

- 5.7 Studentët e AI-së janë të organizuar në Këshillin Studentor, i cili operon nëpërmjet një kuadri rregullator formal **[dok I.1]**. AI promovon dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete të ndryshme **[RVV, fq. 49]**. Studentët janë të përfaqësuar edhe në akreditimin e programit studimor. **[RVV fq. 49;]** Sidoqoftë, një pjesë e vogël studentësh merr pjesë në komitetet kryesore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri re mungesën e përfaqësimit gjithëpërfshirës të studentëve në këtë organ drejtues, sepse të njëjtit studentë ishin anëtarët të çdo strukture. **[Kapitulli I Standardi III.7]**.
- 5.8 AI mbështet aktivitete të ndryshme të studentëve dhe zyrës së shërbimit të studentëve, e cila është përgjegjëse për aktivitetet e studentëve, karrierën profesionale përmes praktikave ose kontakteve me kompani dhe institucione të ndryshme **[RVV fq. 50; dok V.7, 8]** **[RVV fq. 50; dok V.7, 8]** Studentit i sigurohet asistencë mjekësore, shërbim dentar falas dhe karta e studentit **[RVV fq. 50;]** **[Kapitulli I Standardi III.8]**
- 5.9 Zyra e Këshillimit të Karrierës është përgjegjëse për mbështetjen e studentëve në punësim përmes kontakteve me kompani dhe biznese, ose përmes punësimit brenda AI-së në pozicione dhe shërbime të ndryshme. AI pranon që zyra merr pjesë në panairin e karrierës për studentët **[dok. I.47]**, por kjo nuk mbështetet fort nga provat. **[Kapitulli I Standardi III.9]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikave të mira në këtë Fushë Vlerësimi.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi disa dobësi në këtë Fushë Vlerësimi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konsideron si dobësi mungesën e politikës së informacionit dhe veprimeve për shkollën e mesme. (Paragrafi 5.1; **Kapitulli I, Standardi III.1**). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konsideron si dobësi mungesën e infrastrukturës së përshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara **[Paragrafi 5.4; Kapitulli I, Standard III.4]**. Një tjetër dobësi është mungesa e përfaqësimit gjithëpërfshirës të studentëve në organe drejtues **(Paragrafi 5.7; Kapitulli I, Standardi III.7)**.

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm bëri disa rekomandime për këtë Fushë Vlerësimi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon hartimin e një politike për informimin dhe orientimin e nxënësve të shkollës së mesme për AI-në dhe programin studimor, gjithashtu organizimin e fushatës orientuese në shkollat e mesme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon përmirësimin e infrastrukturës për studentët me aftësi të kufizuara. Në përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon përfaqësimin gjithëpërfshirës së studentëve në strukturat ose organet drejtuese të AI-së.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi veprime aktualisht në proces në Fushën e Vlerësimit.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht

Lista e evidencave

A. Faza e Vetëvlerësimit e Akademisë “Ivodent”

1. A. Vetëdeklarimi mbi vërtetësinë e dokumentacionit.pdf
2. B. Deklaratë për plotësimin e standardeve dhe kriterëve të cilësisë.pdf
3. Z. Lista e evidencave për akreditim_AL.pdf
4. C. Self Evaluation Report (SER).EN.pdf [Raporti i Vetëvlerësimit (RVV).AL.pdf]
5. C. Raporti i Vlerësimit të brendshëm (RVB).pdf
6. Z. Self evaluation documents_EN.pdf [Dokumentet e vetëvlerësimit_AL.pdf]
7. I.1 Statuti_Akademise_ivodent.pdf
8. I.2 Urdhër Ministri Statuti Akademia IVODENT.pdf
9. I.3 Vendim_senati_miratim_statuti.pdf
10. I.4 Rregullore e Pergjithshme_ivodent.pdf
11. I.5 Vendim Senati për ngritjen e grupit për hartim dokumentacioni.pdf
12. I.6 Vendim Senati për miratim aktesh rregullatorë.pdf
13. I.7 Vendim Senati për miratim të strategjisë së zhvillimit.pdf
14. I.8 Rregullore Fakulteti_Ivodent.pdf
15. I.9 Rregullore Rektoratit_ivodent.pdf
16. I.10 Rregullore Senati Akademik_ivodent.pdf
17. I.11 Vendim senati kritere dhe miratimi _19.pdf
18. I.12 Vendim senati kritere dhe miratimi _2020.pdf
19. I.13 Vendimi i senatit për ngritjen e GVB.pdf
20. I.14 Shkresa e aplikimit për akreditimin_ASCAL.pdf
21. I.15 Procedure mbledhje Senatit Akademik_Ivodent.pdf
22. I.16 Rregullore Bordit te Administrimit_ivodent.pdf
23. I.17 Rregullore e NJSBC-ivodent.pdf
24. I.18 Rregullore e Keshillit te Etikes_ivodent.pdf
25. I.19 Organigrama e AI.pdf
26. I.20 Organigrama dhe personeli i AI.pdf
27. I.21 Strategjia e zhvillimit te institucionit_18_23_Ivodent.pdf
28. I.22 VKM për hapjen e Kolegjit_Ivoclar.pdf
29. I.23 Leja nga MASH për hapjen e Kolegjit IV&P.pdf
30. I.24 Urdhri MAS për heqjen e pezullimit IVOCLAR (15.3.2016) MAS GA.pdf
31. I.25 Marrëveshja_MASR&IVODENT.pdf
32. I.26 Vendimi i gjykatës për themelimin e IV&P.pdf
33. I.27 Raport i deklarimit te kapaciteteve_18_19_ivodent.pdf
34. I.28 Raporti i deklarimit te kapaciteteve_2017_2018.pdf
35. I.29 Verifikimi i kapaciteteve_MASR.pdf
36. I.30 Plani i aktivitetit_17-18_ivodent.pdf
37. I.31 Plani i aktivitetit_18-19_ivodent.pdf
38. I.32 Plani i aktivitetit_19-20_ivodent.pdf
39. I.33 Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq.pdf
40. I.34 Marrëveshja FMD_UMT.pdf
41. I.35 Marrëveshje_AU.pdf
42. I.36 Marrëveshje U_Aldent.pdf
43. I.37 Agjenda e vlerësimit_institucional_ASCAL.pdf
44. I.38 Kërkesa rishikim tarife ASCAL.pdf
45. I.39 Konfirmimi aplikimit_akreditimit.pdf
46. I.40 Studimi i Tregut 2019.pdf
47. I.41 Urdhër i akreditimit te pare institucional dhe programit.pdf
48. I.42 Raport_financiar_Relacioni Administratorit per Senatin_16_19.pdf
49. I.43 Raport analitik 17-18_Ivodent.pdf
50. I.44 Raport analitik 18-19_Ivodent.pdf

51. I.45 Dosja e programit te studimit_2018_2021.pdf
52. I.46 Marrëveshje_Ivoclar Ltd&ivodent.pdf
53. I.47 Kontrata Al Panairi WORK & STUDY.pdf
54. I.48 Draft Programi Msc në ORTHODONTICS.pdf
55. I.49 Bachelor Orthodontics KFO-ZT 2018.pdf
56. I.50 Statistika_përmbledhëse_16_19.pdf
57. II.1 Rregullore_sekretarisë mësimore_ivodent.pdf
58. II.2 Rregullore e brendshme e bibliotekes_ivodent.pdf
59. II.3 Librari Online R4L_licence_2019.pdf
60. II.4 Rregullore per ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit_ivodent.pdf
61. II.5 Planimetria e akademise_1.pdf
62. II.6 Planimetria_akademisë_2.pdf
63. II.7 CV Stafi Akademik PAE.pdf
64. II.8 CV Stafi Akademik PAK.pdf
65. II.9 CV Stafi Administrativ.pdf
66. II.10 MASR_urdhër_verifikim_kapacitetesh.pdf
67. II.11 Shembull_kontrate_pune_PA_ivodent.pdf
68. II.12 Shembull_kontrate_studenti_AI.pdf
69. II.13 Raporti i Infrastruktures 16-19.pdf
70. II.14 Kerkesa për leje zjarri.pdf
71. III.1 Kerkese per materiale dentare.pdf
72. III.2 Rregullore programi studimi_TLD.pdf
73. III.3 Raport i ndryshimeve te programit TLD_2018.pdf
74. III.4 Planimësimor_18_21_TLD.pdf
75. III.5 Urdhër 236 për ndryshimin e emrit të programit të studimit.pdf
76. III.6 Urdhër_ndryshimi_emërtimit_të_programit.pdf
77. III.7 Urdhër 237 për ndryshimin e emrit të akreditimit të programit.pdf
78. III.8 Urdhër 238 për regjistrimin e formës se diplomës Teknikë e Lartë.pdf
79. III.9 Format diplome_TLD.pdf
80. III.10 Format_suplement_diplome_TLD.pdf
81. III.11 Syllabuset e lendeve_TLD.pdf
82. III.12 Format_syllabus.EN.pdf
83. III.13 Format_syllabus.EN.pdf
84. IV.1 Lista e Botimeve.pdf
85. IV.2 Mobiliteti_në_nivel institucional_AI.pdf
86. IV.3 Shembull i realizimit të praktikës.pdf
87. IV.4 Shembull fletë provimi.pdf
88. IV.5 Të dhëna të përgjithshme aktivitet&kërkim_18_19.pdf
89. IV.6 Programi konferenca + ftesë maj 2018.pdf
90. IV.7 Konferenca të zhvilluara_17_19_AI.pdf
91. IV.8 Lista e trajnimeve të zhvilluara_17_19_AI.pdf
92. IV.9 Workshop KATAOKA Tetor 2014.pdf
93. IV.10 Lista e stafit_lektorëve të huaj&ftuar.pdf
94. IV.11 Osaka OCTC Certification.pdf
95. IV.12 3Shape Certification.pdf
96. IV.13 Rhein83 Certification.pdf
97. IV.14 Refrert Certification.pdf
98. IV.15 Ivoclar Vivadent AG Certification.pdf
99. IV.16 Scheu Dental Certification.pdf
100. IV.17 BEGO Certification.pdf
101. IV.18 Model Marrëveshje_institucionale.pdf
102. IV.19 Marrëveshje_Ivoclar Ltd&ivodent.pdf
103. IV.21 Certifikate kursi Teknik Dentar.pdf
104. V.1 Rregullore aktivitetesh_federata.pdf
105. V.2 Aktivitete_Lista e Regjistrimit të Minifutbollit për meshkuj.PDF

106. V.3 Aktivitete_Minifutboll meshkuj nëntor 2018.pdf
107. V.4 Aktivitete_Kalendari nëntor 2018 (Femra).pdf
108. V.5 Aktivitete_kalendari nëntor 2018 (Meshkuj).pdf
109. V.6 Lista e Regjistrimit VOLEJBOLL FEMRA.PDF
110. V.7 Manuali_keshillimi i karrieres_ivodent.pdf
111. V.8 Veprimtaritë e orientimit të studenteve_zyra e karrierës_18-19__ivodent.pdf
112. V.9 Broshure Fletëpalosja Alvodent (1) 2019.pdf
113. V.10 Broshure Fletëpalosja Alvodent (2) 2019.pdf